



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 111, Datë 24.04.2020

PËR TRANSFERIMIN E PËRHERSHËM TË KANCELARIT NË PROKURORINË E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Në mbështetje të nenit 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 189 të ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenit 50 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nenit 86, pika 3 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” si dhe nenit 7 të vendimit nr. 282, datë 19.12.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për miratimin e rregullave të transferimit të punonjësve administrativë të prokurorive të krimeve të rënda”, pasi vlerësoi kandidaturat për transferimin në pozicionin e kancelarit në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë:

V E N D O S I:

1. Transferimin e përhershëm të znj. Laureta Binaj nga pozicioni Kancelare e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në pozicionin Kancelare në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
2. Znj. Laureta Binaj i nënshtrohet verifikimit të kushteve të sigurisë sipas nenit 6 të ligjit nr. 96/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.
3. Në përfundim të procesit të verifikimit, znj. Laureta Binaj njoftohet për rezultatet dhe statusin përfundimtar në raport me pozicionin në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
4. Ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për zbatimin e këtij vendimi.
5. Të njoftohen për këtë vendim znj. Laureta Binaj dhe Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

6. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë të nesërmen e ditës së hyrjes së tij në fuqi.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI

GENI IBRAHIMI



ANËTAR

KOSTAQ BELURI

ANËTAR

SANDËR BECI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ZV/KRYETARI
ALFRED BALLA

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
TARTAR BAZAJ